- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____ —
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se *[emri i ofertuesit të siguruar]* ka derdhur një depozitë pranë *[emri dhe adresa e bankës]* / është garantuar pranë *[emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit]* me një vlerë prej *[monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6 .

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

1.Gjendja Aktuale e Sistemit Core Bank

Agrokredit sh.a. disponon aktualisht Sistemin Core Bank, një platforme e integruar informatike e cila mbështet proceset kryesore të veprimtarisë financiare, operacionale, kontabel dhe administrative të institucionit. Sistemi është ndërtuar për të mbuluar të gjithë ciklin e menaxhimit të produkteve financiare dhe kredidhenese, duke filluar nga planifikimi dhe konfigurimi i produkteve, procesimi i aplikimeve, administrimi i kredive, menaxhimi i fondeve, raportimi financiar, kontabiliteti, menaxhimi i burimeve njerezore, administrimi i dokumentacionit, mbledhja e detyrimeve dhe proceset e rikuperimit ligjor.

Platforma Core Bank perben sistemin kryesor operacional të institucionit dhe mbështet administrimin e proceseve të biznesit, të dhenave operacionale, të dhenave financiare, proceseve të kontrollit dhe raportimeve të nevojshme për drejtimin dhe monitorimin e aktivitetit të Agrokredit.

Platforma Teknologjike e Sistemit Core Bank

Sistemi Core Bank është ndërtuar mbi platformën Odoo enterprise, i instaluar dhe funksional në infrastrukturën On-Premise të Autoritetit Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të garantojë mirëmbajtjen, suportin teknik dhe funksional, si dhe zhvillimet evolutive të sistemit mbi këtë platformë teknologjike. Cdo zhvillim, përmirësim ose përditësim duhet të jetë plotësisht i pajtueshem me arkitekturën ekzistuese të sistemit, duke ruajtur integritetin e të dhënave, performancën, sigurinë dhe vazhdimësinë e shërbimit.

Sistemi është i instaluar në infrastrukturën fizike (On-Premise) të Agrokredit sh.a. Operatori ekonomik nuk ka detyrim të sigurojë infrastrukturë hardware, platformë cloud apo shërbime hostimi, por do të ofrojë shërbimet e mirëmbajtjes, suportit dhe zhvillimit mbi infrastrukturën ekzistuese të Autoritetit Kontraktor. Përgjegjësia për administrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve hardware, rrjetit, virtualizimit dhe sistemeve bazë mbetet tek Autoriteti Kontraktor, përveç rasteve kur kërkohet asistencë ose rekomandime teknike në kuadër të kontratës.

Sistemi aktual përbehet nga modulet funksionale të mëposhtme:

1.1 Moduli i Produktit të Kredisë

Ky modul mbështet procesin e projektimit, konfigurimit dhe administrimit të produkteve financiare që ofrohen nga Agrokredit. Nepermjet këtij moduli realizohet analiza paraprake e produkteve, planifikimi i tyre, konfigurimi i parametrave baze, përcaktimi i termave dhe kushteve të kreditimit, administrimi i kostove, normave të interesit, periudhave të financimit, periudhave Grace dhe karakteristikave të tjera që lidhen me produktet e kreditimit.

Moduli mundëson krijimin dhe administrimin e karteles së produktit, ku përcaktohen të gjitha rregullat e biznesit që do të përdoren gjatë procesit të aplikimit, vlerësimit dhe administrimit të kredive.

1.1 Moduli i Aplikimit

Moduli i aplikimit mbështet procesin e regjistrimit, administrimit dhe shqyrtimit të aplikimeve për financim. Sistemi mundëson administrimin e aplikimeve për individë dhe biznese, menaxhimin e të dhënave të aplikanteve, dokumentacionit mbështetës, informacionit financiar dhe elementeve të tjera të nevojshme për vlerësimin e kërkesave.

Ky modul përfshin hallkat e miratimit, fazat e procesimit, nivelet e autorizimit dhe proceset vendimarrëse sipas strukture organizative të institucionit. Gjithashtu mundëson ndjekjen e statusit të aplikimit në çdo fazë të procesit dhe ruajtjen e historikut të plote të veprimeve të kryera.

1.2 Moduli i Kredive

Moduli i kredive përben komponentin kryesor të sistemit dhe mbështet administrimin e plote të portofolit të kredive.

Funksionalitetet kryesore të këtij moduli përfshijnë:

- Administrimin e karteles së kredisë;
- Menaxhimin e informacionit të klientit dhe aplikimit;
- Menaxhimin e kolateraleve;
- Disbursimin e kredive;
- Administrimin e kredive me keste dhe planeve të amortizimit;
- Llogaritjen automatike të interesave;

-
- Llogaritjen e penaliteteve;
 - Shperndarjen automatike te pagesave;
 - Menaxhimin e parapagimeve;
 - Menaxhimin e pagesave te parakohshme;
 - Klasifikimin e kredive sipas kategorive te riskut;
 - Faljen e penaliteteve;
 - Shtesat e kredive;
 - Ristrukturimin e kredive;
 - Riskedulimin e kredive;
 - Menaxhimin e moratoriumeve dhe periudhave te ngrirjes se pagesave;
 - Administrimin e proceseve Write-Off sipas rregulloreve te Bankes se Shqiperise;
 - Menaxhimin e kolateraleve gjate gjithë ciklit te jetes se kredise;
 - Mbylljen e parakohshme te kredive;
 - Transferimin e portofoleve te kredive;
 - Gjenerimin e dokumentacionit standard dhe kontraktual.

1.3 Moduli i Menaxhimit te Depozitave

Ky modul mbështet administrimin dhe monitorimin e depozitave te vendosura prane bankave te nivelit te dyte, menaxhimin e afateve, normave te interesit, levizjeve financiare dhe raportimeve perkatese.

1.4 Moduli i Menaxhimit te Borxhit Qeveritar dhe Fondeve te Produkteve

Ky modul mbështet administrimin e fondeve te dedikuara per produktet financiare te institucionit, monitorimin e fondeve te alokuara, detyrimeve perkatese dhe levizjeve financiare qe lidhen me fondet e administruara nga Agrokredit.

1.5 Moduli i Kontabilitetit

Moduli i kontabilitetit mbështet administrimin e plote te proceseve financiare dhe kontabel te institucionit.

Funksionalitetet kryesore perfshijne:

- Kontabilizimin automatik te veprimeve te kredive;
- Menaxhimin e planit kontabel;
- Administrimin e llogarive kontabel;
- Menaxhimin e ditareve kontabel;
- Konfigurimin e skemave te kontabilizimit;
- Konfigurimin e pasqyrave financiare;
- Menaxhimin e klienteve dhe furnitoreve;
- Menaxhimin e artikujve dhe produkteve;
- Administrimin e faturave te shitjes;
- Administrimin e faturave te blerjes;
- Menaxhimin e pagesave te klienteve;
- Menaxhimin e pagesave te furnitoreve;
- Menaxhimin e arkës;
- Menaxhimin e llogarive bankare;
- Rakordimin e transaksioneve bankare;
- Menaxhimin e aktiveve afatgjata;
- Llogaritjen e amortizimit;
- Rivleresimin e llogarive kontabel;
- Gjenerimin e raporteve financiare dhe operative.

1.6 Moduli IFRS

Sistemi aktual perfshin procese dhe funksionalitete qe mbeshtesin raportimin financiar sipas Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar (IFRS).

Nepermjet ketij moduli realizohet:

- Trajtimi i aktiveve sipas standardeve IFRS;
- Administrimi i aktiveve te mbajtura per shitje;
- Menaxhimi i proceseve te amortizimit sipas kerkesave te IFRS;
- Trajtimi i aktiveve ne perdorim sipas IFRS 16;
- Mbeshtetja e proceseve te rivleresimit;
- Gjenerimi i informacionit te nevojshem per raportim financiar dhe auditim.

1.7 Moduli i Raportimit Financiar dhe Rregullator

Sistemi mbeshtet gjenerimin e raporteve financiare, operacionale dhe rregullatore te nevojshme per drejtimin e institucionit dhe permbushjen e kerkesave te organeve mbikeqyrese.

Ky modul perfshin:

- Pasqyrat financiare;
- Bilancin;
- Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve;
- Raportet e kontabilitetit;
- Raportet e aktiveve;
- Raportet RRS;
- Raportet e portofolit te kredive;
- Raportet e fondeve;
- Raportet analitike dhe statistikore;
- Raportimet per Banken e Shqiperise;
- Raportimet per institucionet mbikeqyrese;
- Raportimet menaxheriale per nevoja te brendshme.

1.8 Moduli i Burimeve Njerezore (BNJ)

Moduli i Burimeve Njerezore mbeshtet administrimin e proceseve te menaxhimit te personelit te institucionit. Nepermjet ketij moduli realizohet administrimi i struktures organizative, pozicioneve te punes, kontratave te punes, historikut te punonjesve, lejeve, trajnimeve dhe proceseve te tjera qe lidhen me menaxhimin e burimeve njerezore.

Moduli mbeshtet gjithashtu proceset e administrimit te pagave dhe detyrimeve te personelit, duke siguruar integrim te drejtperdrejte me moduln financiar dhe kontabel te sistemit.

Funksionalitetet kryesore perfshijne:

- Administrimin e te dhenave te punonjesve;
- Menaxhimin e struktures organizative;
- Menaxhimin e kontratave te punes;
- Administrimin e lejeve dhe mungesave;
- Menaxhimin e trajnimeve dhe zhvillimit profesional;
- Administrimin e proceseve te pagave;
- Gjenerimin e detyrimeve financiare te lidhura me personelin;
- Gjenerimin automatik te zerave kontabel qe burojne nga proceset e pagave;

- Integrimin dhe rakordimin automatik te pagave me moduln e kontabilitetit;
- Konsolidimin e informacionit financiar dhe kontabel qe lidhet me kostot e personelit;
- Gjenerimin e raporteve administrative, financiare dhe menaxheriale per burimet njerezore.

1.9 Moduli i Magazines

Moduli i magazines mbështet administrimin e inventarit dhe aktiveve materiale te institucionit.

Funksionalitetet përfshijnë:

- Menaxhimin e magazinave;
- Menaxhimin e artikujve;
- Menaxhimin e njesive matese;
- Regjistrimin e hyrje-daljeve;
- Inventarizimin;
- Raportimet e magazines;
- Konfigurimet e nevojshme per administrimin e inventarit.

1.10 Moduli i Mbledhjes se Detyrimeve (Collection)

Ky modul mbështet procesin e monitorimit dhe ndjekjes se kredive me vonesa.

1.11 Moduli i Rikuperimit Ligjor (Recovery)

Ky modul mbështet administrimin e proceseve ligjore qe lidhen me rikuperimin e detyrimeve dhe menaxhimin e çështjeve gjyqesore te lidhura me portofolin e kredive.

1.12 Moduli CRM (Customer Relationship Management)

Moduli CRM mbështet administrimin e marrëdhënieve me klientet, historikut te komunikimeve, kërkesave, kontakteve dhe aktiviteteve te lidhura me klientet e institucionit.

1.13 Moduli i Menaxhimit te Dokumentacionit (DMS)

Moduli i menaxhimit te dokumentacionit mbështet ruajtjen, organizimin, klasifikimin dhe administrimin elektronik te dokumenteve te lidhura me proceset operative dhe financiare te institucionit.

Ky modul mundeson administrimin e dokumentacionit te klienteve, kredive, kontratave, kolateraleve, proceseve ligjore dhe dokumenteve te tjera institucionale, duke siguruar kontroll aksesi, gjurmueshmeri dhe arkivim te centralizuar.

Nepermjet ketyre moduleve, Sistemi Core Bank perben platformen qendrore te operimit te AgroKredit, duke mbështetur proceset e kreditimit, menaxhimit te fondeve, kontabilitetit, raportimit financiar dhe rregullator, raportimit sipas standardeve IFRS, menaxhimit te burimeve njerezore, administrimit te dokumentacionit, proceseve te collection dhe recovery, si dhe proceseve te tjera mbështetese te institucionit. Sistemi siguron konsolidimin dhe rakordimin e informacionit operacional, financiar dhe kontabel ne nje platforme te vetme, duke mbështetur vendimmarrjen, raportimin institucional dhe administrimin e aktivitetit te institucionit.

2.OBJEKTIVAT, QELLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

Objekti i përgjithshëm i këtij projekti është garantimi i funksionimit të qëndrueshëm, të sigurt dhe të përdorshëm të **Sistemit Core Bank** të Agrokredit, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të vlerësimit, mirëmbajtjes, suportit teknik dhe funksional, si dhe realizimit të përmirësimeve dhe zhvillimeve evolutive të nevojshme për mbështetjen e proceseve operative, financiare dhe administrative të institucionit.

Projekti synon ruajtjen e vazhdimësisë së proceseve të biznesit, përmirësimin e performancës së sistemit, rritjen e sigurisë së informacionit, optimizimin e proceseve ekzistuese, modernizimin teknologjik të platformës, si dhe zhvillimin e funksionaliteteve shtesë të nevojshme për mbështetjen e aktivitetit të institucionit.

Në kuadër të këtij objekti, synohet gjithashtu garantimi i funksionimit të qëndrueshëm të moduleve të kreditimit, kontabilitetit, raportimit financiar dhe rregullator, raportimit sipas standardeve IFRS, menaxhimit të fondëve, menaxhimit të burimeve njerezore, proceseve të collection dhe recovery, si dhe integritetit me sistemet e brendshme dhe të jashtme që mbështesin veprimtarinë e Agrokredit.

2.1. Qëllimi

- Realizimi i një vlerësimi funksional, teknik dhe operacional të Sistemit Core Bank;
- Ofrimi i shërbimeve të mirëmbajtjes korrigjuese, parandaluese dhe evolutive për sistemin;
- Garantimi i disponueshmërisë, stabilitetit, sigurisë dhe performancës së sistemit;
- Adresimi i problematikave teknike dhe funksionale të identifikuara gjatë përdorimit të sistemit;
- Kryerja e përmirësimeve funksionale dhe teknike në përputhje me nevojat e institucionit;
- Zhvillimi i funksionaliteteve të reja që lidhen me proceset ekzistuese të biznesit;
- Modernizimi gradual i arkitektures së sistemit dhe përshtatja e tij me teknologjitë bashkëkohore;
- Mbështetja e zhvillimeve të reja në arkitekturë të bazuar në mikrosërbi (Microservices Architecture);
- Mbështetja e teknologjive të container-izimit dhe orkestrimit të shërbimeve, si Docker, Kubernetes ose ekuivalentet e tyre;
- Përshtatja e sistemit me ndryshimet ligjore, rregullatore, fiskale dhe procedurale që mund të lindin gjatë periudhës së kontratës;
- Mbështetja e proceseve të raportimit financiar dhe kontabel;
- Mbështetja e proceseve të raportimit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS);
- Mbështetja e proceseve të mbylljes mujore, tremujore dhe vjetore të periudhave financiare;
- Mbështetja e proceseve të rakordimit ndërmjet moduleve financiare, kontabel dhe operacionale të sistemit;
- Mbështetja e proceseve të menaxhimit të burimeve njerezore dhe integritetit të tyre me proceset financiare dhe kontabel;
- Përmirësimi i proceseve të raportimit financiar, operacional dhe menaxherial;
- Përmirësimi i integritetit ekzistues dhe realizimi i integritetit të reja me sisteme të brendshme ose të jashtme sipas nevojave të institucionit;
- Optimizimi i performancës së databazës, aplikacionit dhe komponenteve mbështetëse të sistemit;
- Sigurimi i dokumentimit teknik dhe funksional të zhvillimeve të realizuara;

-
- Ofrimi i trajnimeve dhe transferimi i njohurive per perdoruesit dhe administratoret e sistemit;
 - Garantimi i vazhdimësisë së shërbimit dhe mbështetjes teknike gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Sistemi Core Bank, si dhe të gjitha zhvillimet, përmirësimet dhe integrimet që do të realizohen gjatë periudhës së kontratës, duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat e Bankës së Shqipërisë, standardet e sigurisë së informacionit, standardet e raportimit financiar, si dhe kërkesat për disponueshmëri, integritet, konfidencialitet dhe gjurmueshmëri të të dhënave të institucionit.

2.2. Shërbimet e Mirembajtjes, Suportit Funksional, Financiar dhe Teknologjik të Sistemit

Sherbimet e Mirembajtjes, Suportit dhe Zhvillimit të Sistemit

Pas përfundimit të fazës së assessment-it dhe miratimit të raportit përkatës nga institucioni përfitues, operatori ekonomik fitues duhet të sigurojë mirembajtjen korrigjuese, parandaluese dhe evolutive të Sistemit Core Bank gjatë gjithë periudhës së kontratës, duke garantuar funksionimin e pandërprerë të të gjitha moduleve funksionale, integritetin e të dhënave, performancën e sistemit, sigurinë e informacionit dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore, rregullatore dhe procedurale të institucionit.

Shërbimi i mirembajtjes duhet të përfshijë jo vetëm adresimin e problematikave teknike dhe funksionale të evidentuara gjatë përdorimit të sistemit, por edhe realizimin e përmirësimeve, optimizimeve dhe zhvillimeve të nevojshme për garantimin e funksionimit të vazhdueshëm të proceseve të biznesit të institucionit.

Ndarja e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe zhvillimeve evolutive

Për qëllime të kësaj kontrate, shërbimet ndahen në dy kategori kryesore:

- a) Shërbimet e mirëmbajtjes, të cilat përfshijnë korrigjimin e defekteve (bug fixing), instalimin e përditësimeve (updates) dhe patch-eve të sigurisë, monitorimin e vazhdueshëm të sistemit, optimizimin e performancës, administrimin e databazës, mbështetjen teknike dhe funksionale, si dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm për garantimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe të sigurtë të sistemit.
- b) Zhvillimet evolutive, të cilat përfshijnë implementimin e funksionaliteteve të reja, përmirësimin e proceseve ekzistuese, realizimin e integriteteve me sisteme të tjera, zhvillimin e raporteve të reja, ndryshimet arkitekturore dhe çdo zhvillim tjetër që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor gjatë periudhës së kontratës. Këto zhvillime realizohen vetëm mbi bazën e kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe në përputhje me objektin dhe kushtet e kontratës.

Ne kuader te mirembajtjes, operatori ekonomik duhet te garantoje disponueshmerine e stafit te specializuar teknik, funksional dhe financiar, te afte per te mbeshtetur te gjitha modulet e Sistemit Core Bank, perfshire modulet e kreditimit, kontabilitetit, raportimit financiar dhe rregullator, raportimit sipas standardeve IFRS, menaxhimit te fondeve, burimeve njerezore (BNJ), collection, recovery, CRM, menaxhimit te dokumentacionit dhe integriteteve me sisteme te tjera.

Operatori ekonomik duhet te ofroje:

- Asistence teknike dhe funksionale gjate proceseve te mbylljes mujore, tremujore dhe vjetore te bilanceve;
- Asistence gjate proceseve te rakordimit financiar dhe kontabel;
- Asistence gjate proceseve te rakordimit ndermjet moduleve te kredive, kontabilitetit dhe burimeve njerezore;
- Asistence gjate proceseve te raportimit financiar, rregullator dhe menaxherial;
- Mbeshtetje per proceset e raportimit sipas standardeve IFRS;
- Implementimin e ndryshimeve qe burojne nga ndryshimet ligjore, fiskale, rregullatore dhe proceduriale;
- Permiresimin e vazhdueshem te proceseve dhe funksionaliteteve ekzistuese te sistemit;
- Zhvillimin e funksionaliteteve te reja sipas nevojave te institucionit gjate periudhes se kontrates.

Operatori ekonomik duhet te garantoje qe Sistemi Core Bank te jete vazhdimisht i perditesuar dhe ne perputhje me standardet e sigurise dhe praktikat me te mira te industrise.

Per kete qellim duhet te realizohen:

- Instalimi i perditesimeve (Updates) dhe Patch-eve te sigurise;
- Perditesimi i komponenteve aplikative dhe infrastrukture sipas rekomandimeve te prodhuesve;
- Adresimi i vulnerabiliteteve te sigurise te identifikuara gjate auditimeve ose monitorimeve periodike;
- Analiza periodike e performances se sistemit;
- Optimizimi i databazes, proceseve dhe komponenteve aplikative;
- Monitorimi i vazhdueshem i log-eve dhe alarmeve te sistemit;
- Analizimi dhe adresimi proaktiv i problematikave te mundshme perpara se ato te ndikojne ne funksionimin e sistemit.

Operatori ekonomik duhet te garantoje qe sistemi te mbeshtese gjenerimin ne kohe reale te informacionit operacional, financiar dhe kontabel, duke mundesuar:

- Gjenerimin e gjendjeve financiare ne kohe reale;
- Gjenerimin e pasqyrave financiare;
- Gjenerimin e raporteve financiare, operative dhe menaxheriale;
- Rakordimin e informacionit financiar ndermjet moduleve te sistemit;
- Rakordimin e kredive me regjistrimet kontabel;
- Rakordimin e proceseve te pagave dhe detyrimeve te personelit me regjistrimet kontabel;
- Konsolidimin automatik te kostove te personelit ne pasqyrat financiare;
- Verifikimin e integritetit dhe saktetise se te dhenave;
- Evidentimin dhe adresimin e diferencave te konstatuara gjate proceseve te rakordimit.

Operatori ekonomik duhet te ofroje asistencë të vazhdueshme për proceset e backup-it, recovery-t, testimit të rikuperimit, vazhdimësi të biznesit dhe rikuperimit nga fatkeqësitë, në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara nga AgroKredit.

Në kuadër të modernizimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të Sistemit Core Bank, operatori ekonomik duhet të disponojë kapacitete profesionale dhe teknike për administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemeve të bazuara në arkitekturë mikrosërveshesh (Microservices Architecture).

Për këtë qëllim:

- Komponentet e rinj që do të zhvillohen gjatë periudhës së kontratës duhet të implementohen në mënyrë të pavarur dhe të mund të vendosen në punë pa ndikuar funksionimin e komponenteve të tjera të sistemit;
- Zhvillimet e reja duhet të jenë të përshtatshme për ekzekutim në mjedisë të container-izuar;
- Sistemi duhet të mbështesë teknologjitë Docker ose ekuivalentet e tyre;
- Operatori ekonomik duhet të garantojë krijimin, administrimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e imazheve Docker për komponentet e sistemit;
- Operatori ekonomik duhet të garantojë monitorimin, optimizimin dhe adresimin e problematikave që lidhen me mjediset e container-izuar;
- Arkitektura duhet të mbështesë shkallëzimin horizontal të komponenteve sipas nevojave të institucionit;
- Sistemi duhet të mbështesë monitorimin e centralizuar të shërbimeve, mbledhjen e log-eve, auditimin e veprimeve dhe gjurmueshmërinë e plote të proceseve;
- Operatori ekonomik duhet të disponojë kapacitete për administrimin e platformave Kubernetes ose ekuivalente;
- Sistemi duhet të mbështesë procese të automatizuara të ndërtimit, testimit dhe publikimit të komponenteve aplikative (CI/CD).

Operatori ekonomik duhet të dokumentojë të gjitha ndryshimet funksionale, teknike dhe infrastrukturore të realizuara gjatë periudhës së kontratës, si dhe të sigurojë transferimin e njohurive tek stafi teknik dhe funksional i AgroKredit.

2.3. Detyrat specifike

Gjatë muajit të parë të kontratës, operatori ekonomik duhet të realizojë një assessment të plote funksional, teknik dhe operacional të Sistemit Core Bank.

Qëllimi i këtij assessment-i është njohja e plote e sistemit, proceseve të biznesit, arkitekture teknike, integriteteve ekzistuese dhe nevojave aktuale të institucionit, me qëllim planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes, suportit, modernizimit dhe përmirësimeve gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Assessment-i duhet të përfshijë minimalisht:

- Analizimin e të gjitha moduleve funksionale të Sistemit Core Bank;
- Analizimin e proceseve operative, financiare dhe administrative të institucionit;
- Analizimin e proceseve të kreditimit, menaxhimit të fondeve, collection, recovery, CRM dhe menaxhimit të dokumentacionit;

-
- Analizimin e proceseve te kontabilitetit, raportimit financiar, raportimit rregullator dhe raportimit sipas standardeve IFRS;
 - Analizimin e moduleve te Burimeve Njerezore (BNJ), proceseve te pagave, konsolidimit financiar dhe rakordimeve me modulën e kontabilitetit;
 - Analizimin e integriteteve ekzistuese me sistemet e brendshme dhe te jashtme;
 - Analizimin e arkitektures aplikative, komponenteve software dhe mekanizmeve te komunikimit ndermjet moduleve;
 - Analizimin e databazave, strukturese se te dhenave dhe proceseve te rakordimit te informacionit;
 - Analizimin e infrastrukturese se hostimit dhe komponenteve mbeshtetese te sistemit;
 - Analizimin e mekanizmeve te sigurise se informacionit;
 - Analizimin e performances, disponueshmerise dhe shkallezueshmerise se sistemit;
 - Analizimin e mundesive per modernizimin gradual te sistemit ne arkitektura te bazuara ne mikroshterbi (Microservices Architecture);
 - Evidentimin e problematikave teknike dhe funksionale;
 - Evidentimin e risqeve operacionale, teknike dhe te sigurise;
 - Evidentimin e nevojave per permiresime funksionale, teknike dhe arkitekturore.

Ne perfundim te assessment-it, operatori ekonomik duhet te paraqese nje raport te detajuar, i cili do te permbaje minimalisht:

- Gjendjen aktuale te Sistemit Core Bank;
- Gjendjen aktuale te moduleve funksionale dhe integriteteve;
- Problematikat teknike dhe funksionale te identifikuar;
- Risqet e evidentuara;
- Analizen e performances dhe sigurise se sistemit;
- Analizen e proceseve financiare, kontabel dhe te raportimit;
- Analizen e proceseve te Burimeve Njerezore dhe integritetit te tyre me kontabilitetin;
- Rekomandimet teknike, funksionale dhe arkitekturore;
- Planin e mirembajtjes dhe suportit per periudhen e kontrates;
- Planin e permiresimit dhe optimizimit te sistemit;
- Planin paraprak te zhvillimeve evolutive te rekomanduara;
- Planin e modernizimit teknologjik dhe permiresimit te arkitektures se sistemit.

Raporti i assessment-it duhet te miratohet nga institucioni perfitues dhe do te sherbeje si dokument baze per planifikimin, prioritarizimin dhe realizimin e aktiviteve te mirembajtjes, suportit, zhvillimit dhe permiresimit te Sistemit Core Bank gjate gjithë periudhes se kontrates.

3. RAPORTIMI

3.1. Kerkesat e Raportimit

Operatori ekonomik do te paraqese raporte periodike mbi aktivitetet e realizuara gjate zbatimit te kontrates per mirembajtjen, suportin dhe zhvillimin evolutiv te Sistemit Core Bank.

Raportimi do te realizohet ne gjuhen shqipe dhe do t'i dorezohet grupit te punes per ndjekjen e kontrates, te percaktuar nga institucioni perfitues.

Raportet minimale qe duhet te dorezohen jane:

3.2. Raporti i Assessment-it Fillestar

Brenda muajit te pare te kontrates, operatori ekonomik duhet te realizoje assessment-in funksional, teknik dhe operacional te Sistemit Core Bank dhe te paraqese raportin perkates.

Raporti duhet te permbaje minimalisht:

- Pershkrimin e gjendjes aktuale te Sistemit Core Bank;
- Analizen e moduleve funksionale te sistemit, perfshire modulet e kreditimit, kontabilitetit, raportimit financiar dhe rregullator, raportimit IFRS, burimeve njerezore (BNJ), collection, recovery, CRM dhe menaxhimit te dokumentacionit;
- Analizen e proceseve te biznesit;
- Analizen e proceseve financiare, kontabel dhe te raportimit;
- Analizen e proceseve te pagave, konsolidimit financiar dhe rakordimeve ndermjet moduleve;
- Analizen e arkitektures teknike dhe aplikative;
- Analizen e databazave, struktures se te dhenave dhe integriteteve ekzistuese;
- Analizen e infrastruktures dhe mjediseve te hostimit;
- Analizen e sigurise se informacionit dhe kontrollit te aksesit;
- Analizen e performances, disponueshmerise dhe shkallezueshmerise se sistemit;
- Evidentimin e problematikave teknike dhe funksionale;
- Evidentimin e risqeve operationale, teknike dhe te sigurise;

-
- Rekomandimet per permiresim dhe modernizim;
 - Planin paraprak te aktiviteve te mirembajtjes, suportit dhe zhvillimeve evolutive.

Raporti i Assessment-it do te sherbeje si dokument baze per planifikimin e aktiviteve gjate gjithe periudhes se kontrates.

3.3. Raportet Mujore te Aktivitetit

Operatori ekonomik duhet te paraqese raporte mujore te aktivitetit gjate gjithe periudhes se kontrates.

Raporti mujor duhet te permbaje minimalisht:

- Aktivitetet e realizuara gjate periudhes raportuese;
- Problematikat e adresuara dhe statusin e tyre;
- Incidentet dhe kerkesat e trajtuara;
- Aktivitetet e mirembajtjes korigjuese, parandaluese dhe evolutive;
- Ndryshimet dhe permiresimet funksionale te realizuara;
- Aktivitetet e suportit teknik dhe funksional;
- Aktivitetet e suportit financiar dhe kontabel;
- Aktivitetet qe lidhen me raportimin financiar dhe kerkesat IFRS;
- Aktivitetet qe lidhen me modulet e Burimeve Njerezore (BNJ), pagat dhe rakordimet financiare;
- Aktivitetet e sigurise se informacionit dhe monitorimit te vulnerabiliteteve;
- Perditesimet, patch-et dhe permiresimet teknologjike te realizuara;
- Aktivitetet e backup-it, recovery-t dhe vazhdimet e biznesit;
- Gjendjen e kerkesave te hapura dhe planin e adresimit te tyre;
- Aktivitetet e planifikuara per periudhen pasardhese.

3.4. Raportet e Nderhyrjeve dhe Zhvillimeve

Per çdo nderhyrje madhore, zhvillim funksional, ndryshim arkitekturor, integrim te ri ose implementim te rendesishem, operatori ekonomik duhet te dorezoje dokumentacionin dhe raportin teknik perkates.

Raporti duhet te permbaje minimalisht:

- Pershkrimin e ndryshimit;
- Arsyetimin dhe objektivin e realizimit;

-
- Modulet dhe komponentet e prekur;
 - Analizen e ndikimit ne sistem;
 - Testimet e kryera;
 - Rezultatet e implementimit;
 - Dokumentacionin teknik dhe funksional perkates;
 - Rekomandimet per administrimin dhe mirembajtjen e metejshme.

3.5. Raporti Vjetor i Performances se Sistemit

Ne fund të vitit kontraktor, operatori ekonomik duhet te paraqese nje raport te konsoliduar mbi gjendjen e Sistemit Core Bank.

Raporti duhet te permbaje:

- Analizen e performances se sistemit;
- Analizen e disponueshmerise dhe incidenteve;
- Analizen e sigurise se informacionit;
- Permbledhjen e zhvillimeve dhe permiresimeve te realizuara;
- Analizen e risqeve dhe rekomandimet per vitin pasardhes.

3.6. Raporti Perfundimtar i Kontrates

Ne perfundim te kontrates operatori ekonomik duhet te paraqese raportin perfundimtar, i cili do te permbledhe te gjitha aktivitetet e realizuara gjate periudhes se kontrates, problematikat e adresuara, zhvillimet dhe permiresimet e realizuara, integrimet e implementuara, rekomandimet per vijimesine e sistemit dhe gjendjen perfundimtare te Sistemit Core Bank.

3.7. Dorezimi dhe Miratimi i Raporteve

Te gjitha raportet do t'i dorezohen grupit te punes per ndjekjen e kontrates, te percaktuar nga institucioni perfitues.

Institucioni perfitues do te shqyrtoje raportet e paraqitura dhe do te paraqese komentet ose kerkesat per plotesim brenda afateve te percaktuara ne kontrate.

Konfirmimi i realizimit te aktiviteve dhe pranimit i raporteve do te kryhet nga perfaqesuesit e autorizuar te institucionit perfitues dhe operatorit ekonomik, nepermjet procesverbaleve te pranimit, raporteve te konfirmimit ose formave te tjera te dakordesuara ndermjet paleve.

Raportet mujore te miratuara do te sherbejne si baze per verifikimin e realizimit te sherbimeve, monitorimin e ecurise se kontrates dhe certifikimin e aktiviteve te kryera gjate periudhes raportuese.

4. KOMUNIKIMI ME SISTEME TE TJERA

Sistemi Core Bank duhet të mbështesë komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave me sisteme të brendshme dhe të jashtme, me qëllim automatizimin e proceseve të biznesit, eliminimin e ndërhyrjeve manuale, rritjen e saktësisë së të dhënave, përmirësimin e proceseve operacionale dhe financiare, si dhe garantimin e raportimit të saktë dhe në kohë reale.

Web Service-et, API-te dhe mekanizmat e tjerë të komunikimit që do të nevojiten për realizimin e ndërveprimeve do të analizohen dhe specifikohen gjatë fazës së assessment-it dhe analizës funksionale, duke përcaktuar fushat e të dhënave, formatet e komunikimit, frekuencën e shkëmbimit të informacionit, mekanizmat e autentikimit, kërkesat e sigurisë dhe mënyrën e integritetit me sistemet përkatëse.

Operatori ekonomik duhet të realizojë, përmirësojë, optimizojë dhe mirëmbajë ndërveprimet ekzistuese, si dhe të implementojë ndërveprime të reja që mund të kërkojnë gjatë periudhës së kontratës si rezultat i:

- Nevojave operative të institucionit;
- Ndryshimeve ligjore, fiskale dhe rregullatore;
- Ndryshimeve në kërkesat e Bankës së Shqipërisë ose institucioneve të tjera mbikeqyrese;
- Përmirësimit të proceseve të biznesit;
- Kërkesave për automatizimin e proceseve ekzistuese;
- Krijimit të shërbimeve të reja ose proceseve të reja institucionale;
- Kërkesave për raportim financiar, kontabel dhe statistikor;
- Nevojave për shkëmbim informacioni me institucione shtetërore, financiare ose organizata të tjera partnere.

Sistemi duhet të jetë i aftë të integrohet me sisteme të institucioneve shtetërore, institucioneve financiare, organizatave ndërkombëtare, sistemeve të pagesave, sistemeve të raportimit financiar, sistemeve të menaxhimit të kredive dhe fondeve, si dhe me çdo sistem tjetër të nevojshëm për realizimin e funksioneve të institucionit.

Keto integritime mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në:

- Sistemet e Bankës së Shqipërisë;
- Sistemet e raportimit rregullator dhe financiar;
- Sistemet e bankave të nivelit të dytë;
- Sistemet e transfertave financiare dhe pagesave;
- Platforma të pagesave vendase ose ndërkombëtare;
- Sisteme të operatorëve financiarë si Western Union ose sisteme të ngjashme;
- Sisteme të identifikimit dhe verifikimit të klienteve;

-
- Sisteme te menaxhimit te kolateraleve;
 - Sisteme te menaxhimit te kredive dhe fondeve;
 - Sisteme te raportimit statistikor dhe menaxherial;
 - Sisteme te administrimit te burimeve njerezore dhe pagave;
 - Sisteme shteterore te shkembimit te te dhenave;
 - Platforma kombetare ose nderkombetare te nderveprimit elektronik;
 - Çdo sistem tjetër që identifikohet gjatë periudhës së kontratës si i nevojshëm për realizimin e proceseve të institucionit.

Institucioni përfitues do të jetë përgjegjës për koordinimin institucional me palet e treta dhe për vendosjen në dispozicion të operatorit ekonomik të informacionit, dokumentacionit teknik, specifikimeve funksionale, API-ve, Web Service-eve, kredencialeve të aksesit, mjediseve të testimit dhe çdo elementi tjetër të nevojshëm për realizimin e integriteteve.

Operatori ekonomik do të jetë përgjegjës për analizimin, projektimin, implementimin, testimin, dokumentimin, monitorimin dhe vendosjen në punë të nderveprimeve, duke garantuar siguri, integritetin, gjurmueshmërinë, performancën dhe vazhdimësinë e shkembimit të të dhënave ndërmjet sistemeve.

Të gjitha integritet e reja duhet të realizohen duke përdorur standarde të hapura komunikimi dhe arkitektura moderne të integritetit të bazuara në API, Web Services, REST, SOAP ose teknologji ekuivalente, duke garantuar mundësinë e zgjerimit dhe mirëmbajtjes së tyre në të ardhmen.

Operatori ekonomik duhet të dokumentojë të gjitha integritet ekzistuese dhe ato të reja, duke përfshirë dokumentacionin teknik, strukturat e shkembimit të të dhënave, mekanizmat e autentikimit, rregullat e biznesit dhe procedurat operacionale për administrimin dhe monitorimin e tyre.

5. MIRËMBAJTJA

5.1. Specifikimet teknike për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit

Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e sistemit për menaxhimin dhe monitorimin e transportit ndërqytetas janë absolute në komponentet e mëposhtme:

1. Monitorimi periodik i rregullt i roleve dhe aktivitetit të përdoruesve të sistemit. Kompania duhet të nxjerrë raporte pas monitorimeve periodike.
2. Vlerësim i raporteve të monitorimit dhe përpilim i raporteve për përmirësimin e infrastrukurës, pa përjashtuar edhe sugjerimet në adresë të infrastrukurës.
3. Izolimin dhe diagnostifikimin e problemeve që afektojnë sistemin. Përgatitja e raportit dhe sugjerimet përkatëse për problemin.
4. Kompania duhet të garantojë suport në rast se një faktor i brendshëm apo i jashtëm afekton sistemin.

Për efekt të kësaj kontrate, faktorë të brendshëm konsiderohen, pa u kufizuar në: gabime funksionale të aplikacionit, konfigurime të pasakta të sistemit, problem të databazës, degradim të performancës, dështime të proceseve të backup-it, gabime gjatë përditësimeve software, problem të integriteteve, konfigurime të roleve dhe përdoruesve, si dhe çdo problematike tjetër që lidhet me komponentet software të sistemit.

Faktorë të jashtëm konsiderohen, pa u kufizuar në: ndryshime ligjore ose rregullatore që kërkojnë përshtatje të sistemit, ndryshime në shërbimet ose API-te e paleve të tret, probleme të rrjetit ose komunikimit, incidente të sigurisë kibernetike, si dhe ngjarje të tjera të jashtme që ndikojnë në funksionimin normal të sistemit. Në rastet kur shkak i incidentit nuk lidhet me komponentet software të sistemit, operatori ekonomik do të ofrojë analizë, asistencë teknike dhe rekomandime për adresimin e problematikës, në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor ose palët përgjegjëse.

5. Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.
6. Kontroll i detajuar i log-eve të sistemit.
7. Të tjera

Operatori ekonomik fitues duhet të ndermarre veprime proaktive dhe raportuese në rast të:

- Mosfunksionimit të shërbimeve të instaluar në role perkatese
- Rritja e skedareve të log-eve në mënyrë të tillë që të efektojnë performancën.
- Performance dhe disponueshmëri të ulët të funksioneve të sistemit.
- Kontrolli i alerteve, të log-eve dhe verifikimi i error-eve.
- Verifikimi i realizimit me sukses të backup.
- Verifikimi i të gjitha instancave që të jenë në gjendje pune.
- Përcaktimi i procedurave dhe kontrolleve të sigurisë.
- Verifikimi i hapësirave (disk space). Verifikimi i madhësisë së databazës (ndryshimi i madhësisë së të dhënave).
- Monitorimi i sigurisë së databazës;
 - Kontrolli i përdoruesve dhe të drejtave të tyre
 - Kontrolli i roleve dhe grupeve, me parimin e përdoruesve me të drejta minimale për të kryer rolin e tyre
 - Bllokimi i llogarive dhe mbyllja e sesioneve të userave që nuk janë me në përdorim.
- Testim i procedurave restore me backup-in me të fundit.
- Implementimi i patch, update, security issue.
- Kontroll i të gjitha shërbimeve që përdoren në aplikacion.

5.2. Sherbimi i mirembajtjes per Sistemet Operative, Databaze, etj.

Qellimi i sherbimit ne kete komponent eshte realizimi i proceseve te me poshtme:

1. Operatori i mirembajtjes te mundesoje kryerjen e rregullt te proceseve te auditimit te sigurise, sipas standardeve dhe praktikave ne fuqi. Kjo kerkese siguron qe auditimi i sigurise te perfshije qarte hapat dhe proceset teknike te meposhtme:
 - a. Identifikimi dhe dokumentimi i asetave kritike te sistemit;
 - b. Vleresimi i konfigurimeve te sistemit dhe zbatimi i politikave te sigurise;
 - c. Kontrolli i aksesit, perfshire verifikimin e te drejtave te perdoruesve dhe mekanizmave te autentifikimit;
 - d. Monitorimi i log-eve dhe gjurmeve te sigurise per identifikimin e ngjarjeve te dyshimta;
 - e. Hartimi i raporteve te auditimit me rekomandime konkrete per permiresime;
 - f. Ndjekja e planit te veprimit per adresimin e gjetjeve kritike.
 - g. Ne funksion te ketij sherbimi, kerkohet qe Operatori Ekonomik te disponoje kapacitete profesionale per teknologjine e hostimit te mikrosherbimeve.
 - h. Ky kriter siguron qe administrimi, mirembajtja dhe zhvillimi i platformave te bazuara ne containera, te realizohet ne perputhje me standardet, duke garantuar:
 - i. Menaxhim te sigurt dhe efikas te container-eve;
 - ii. Zhvillim dhe implementim te mikrosherbimeve sipas praktikave me te mira;
 - iii. Sigurimin e vazhdueshmerise dhe performances se infrastruktures se virtualizuar;
 - iv. Zbatim te politikave te sigurise dhe automatizim te proceseve operative.
 - i. Ne kuader te mirembajtjes se vazhdueshme te platformes Core Bank, eshte e domosdoshme te garantohet ofrimi i sherbimeve te testimit te automatizuar, me qellim rritjen e cilesise, stabilitetit dhe sigurise se sistemit. Ky kriter siguron qe proceset e testimit te kryhen ne menyre te standardizuar, profesionale dhe te besueshme, duke garantuar:
 - i. Zbatimin e metodologjive te njohura per testimet e automatizuara;
 - ii. Detektimin e hershem te defekteve ne komponentet ekzistues dhe gjate permiresimeve te reja;
 - iii. Permiresimin e vazhdueshem te cilesise se sherbimeve te platformes;
 - iv. Sigurimin e stabilitetit te versioneve te reja perpara vendosjes ne mjedisin e prodhimit;

- v. Reduktimin e kohes se testimit dhe minimizimin e nderprerjeve te mundshme.
- j. Mirembajtjen dhe kryerjen e procedurave per perditesimin (update) e vazhdueshem te ketyre sistemeve, ne menyre qe te garantohet stabiliteti dhe mos nderprerja e sherbimit ne asnje rast.
- a. Instalime dhe konfigurime te sistemit te operimit nese do te jete e nevojshme duke perfshire softet ndihmese per mirefunksionimin e sistemit.
- b. Diagnostikim dhe riparim te problemeve qe mund te dalin gjate periudhes se ketij sherbimi.

5.3. Pergjigja dhe shkallezimi i sherbimit

Ne tabelen e meposhtme percaktohet kategorizimi i seriozitetit te problemeve dhe koha e pergjigjes per zgjidhjen e tyre.

Kategoria A (Kritik/ I Larte)	Kategoria B (I Mesem)	Kategoria C (I Ulet)
Mos funksionimi i aplikacionit krijon apo rrezikon shume aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit krijon vonesa ne aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit pengon ne menyre minimal aktivitetin
Numri i perdoruesve te ndikuar		
Mos funksionimi i sistemit ndikon nje numer shume te madh te perdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon nje numer te vogel te perdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjeserisht ne disa perdorues
Pezullimi i punes		
Mos funksionimi i sistemit pengon perdoruesit <u>te realizojne pjesen me te madhe te punes se tyre.</u>	Mos funksionimi i sistemit pengon perdoruesit <u>te realizojne pjese te punes se tyre</u>	Mos funksionimi i sistemit pengon perdoruesit <u>te realizojne disa pjese te vogla te punes se tyre,</u>
Zgjidhje alternative e perkohshme		
<u>Nuk ka nje menyre alternative</u> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit	<u>Ka pjeserisht nje menyre alternative</u> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.	<u>Ka nje menyre alternative</u> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.
Koha e pergjigjes		
- o 10 min. per te kthyer pergjigje - o Ne vend brenda 1 ore.	- o 30 min.per te kthyer pergjigje - o Ne vend brenda 2 oreve	- o 60 min.per te kthyer pergjigje - o Ne vend brenda 4 oreve
Koha e zgjidhjes		
